

Përmbledhje

Natalia Skogberg, Päivikki Koponen, Eero Lilja, Sara Austero, Tyler Prinkey, Anu E. Castaneda. Impact of Covid-19 on the health and wellbeing of persons who migrated to Finland. The MigCOVID Survey 2020–2021. [Ndikimet e epidemisë Covid-19 në shëndetin dhe mirëqenjen e personave të ardhur në Finlandë. Hulumtimi MigCOVID 2020–2021.] Raportti 8/2021. Helsinki, Suomi 2021. ISBN978-952-343-682-4 (painettu); ISBN978-952-343-683-1 (verkkojulkaisu).

Epidemia Covid-19 dhe masat kufizuese lidhur me epideminë kanë pasur ndikime të dukshme në shëndetin e popullsisë. Ndikimet kanë qenë më të theksuara te personat, të cilët edhe para epidemisë Covid-19 kanë pasur pozitivitet më të dobët në shoqëri. Qëllimi i këtij raporti ishte të qartësojë ndikimet e epidemisë Covid-19 në jetën e përditshme të personave të ardhur në Finlandë, në shëndetin e tyre, në mirëqenjen mendore dhe në cilësinë e jetës.

Në këtë hulumtim janë përdorur të dhëna nga studimi i realizuar nga Instituti kombëtar për shëndetësi dhe mirëqenje lidhur me ndikimet e epidemisë me korona në mirëqenjen e personave të ardhur në Finlandë (MigCOVID). Të dhënat hulumtuese janë mbledhur nga muaji tetor 2020 deri në muajin shkurt 2021, në kohën e njejtë kur në Finlandë ishte vala e dytë e epidemisë Covid-19. Në hulumtimin MigCOVID pjesëmarrës ishin gjithësejtë 3 668 persona nga moshë 20 deri në 66 vjeç. Përgjigjësja e tyre në përqindje ishte 60 %. Në hulumtimin përcjellës nga FinTerveys 2021, mostra të zgjedhura nga grupmosha e njejtë u përdorën si të dhëna referente që përshkruajnë të gjithë popullsinë (n=3 490, përgjigjësja në përqindje ishte 51 %).

Janë vërejtur dallime të rëndësishme statistikore bazuar në gjithë popullsinë, ashtuqë pjesa më e madhe e personave të ardhur në Finlandë kishin shqetësime lidhur me epideminë e Covid-19. Shqetësimet ishin lidhur me mundësinë e infeksionit me Covid-19 (nga e gjithë popullsia 18 % në raport apo krahasuar me personat e ardhur në Finlandë që ishte 29 %), infektimi i të tjerëve (31 % në raport me 39 %), infeksioni i personave të afërm (40 % në raport me 52 %), përjetimin e diskriminimit apo të anashkalimit për shkak të Covid-19 (7 % në raport me 16 %), vazhdimin e punës (8 % në raport me 30 %), aftësinë e udhëheqjes shtetërore për të trajtuar krizën (14 % në raport me 25 %) dhe në njohurinë e përkujdesjes shëndetësore për të trajtuar të gjithë pacientët (15 % në raport me 29 %).

Krahasuar me gjithë popullsinë, një pjesë dukshëm më e madhe e personave të ardhur në Finlandë, raportuan rënje të shpresës për të ardhmen (nga e gjithë popullsia 30 % në raport apo krahasuar me personat e ardhur në Finlandë që ishte 38 %) si dhe rritjen e përjetimit të vetmisë (28 % në raport me 36 %), vështërsi gjumi (10 % në raport me 18 %) dhe në pirjen e duhanit (2 % në raport me 4 %). Prej personave të ardhur në Finlandë 9 % e tyre kanë raportuar se në shtëpi kanë përjetuar rënjen e sigurisë dhe 39 % e tyre rënjen e aktivitetit fizik. Poashtu edhe dallime të mëdha statistikore janë vërejtur në dobësimin e konsideruar apo shumë të theksuar ekonomik (nga e gjithë popullsia 6 % në raport me personat e ardhur në Finlandë që ishte 23 %). Për disa, epidemia Covid-19 kishte poashtu edhe ndikime pozitive. Në raport me gjithë popullsinë, personat e ardhur në Finlandë kanë raportuar më shpesh një rritje të mbajtjes së raporteve me miqët (nga e gjithë popullsia 7 % në raport me personat e ardhur në Finlandë 16 %) dhe më shumë shpresë për të ardhmen në raportet (7 % në raport me 20 %) si dhe rënje të vetmisë (2 % në raport me 6 %), mendimet kundërtëse brenda familjes (3 % në raport me 6 %) dhe ngrënja e ushqimit mes racioneve (5 % në raport me 9 %).

Gjithësej 15 % e personave të ardhur në Finlandë kanë raportuar se janë trajtuar më me mosrespekt, janë fyer verbalisht, janë kërcënuar apo shqetësuar gjatë kohës së epidemisë Covid-19. Ata të cilët janë trajtuar më me mosrespekt sesa të tjerët (janë 11 % e të gjithë të anketuarve), 46 % e tyre kanë raportuar se kjo ka ndodhur çdo javë. Ata të cilët janë ofenduar ose përndryshe janë fyer verbalisht (7 %), 35 % e tyre raportuan se kjo ka ndodhur së paku një herë në çdo javë. Kërcënime dhe shqetësime raportuan 5 % nga të anketuarit. Prej tyre 24 % raportuan se kjo ka ndodhur së paku një herë në javë.

Gjithësej 81 % e personave të ardhur në Finlandë dhe 84 % nga e gjithë popullsia raportuan se ishin plotësisht të aftë për punë. Megjithatë, dallime statistikore të dukshme u vërejtën në raport me gjithë popullsinë në disa fusha të shëndetësisë, të kapaciteteve vepruese dhe të mirëqenjes. Krahasuar me gjithë popullsinë, personat e ardhur në Finlandë kanë raportuar më rrallë se kanë përjetuar shëndet të mirë / apo deri diku të mirë (e gjithë popullsia 80 % në krahasim me personat e ardhur në Finlandë që ishte 70 %), memorja ka funksionuar mirë apo shumë mirë (82 % në raport me 75 %) dhe cilësi jetësore shumë të mirë apo të mirë (78 % në raport me 70 %), aty ku kanë pasur ngarkesë psikike (11 % në raport me 20 %) dhe paraqitja e dëmtimeve të rënda të aftësive vepruese (5 % në raport me 11 %) që ishte më e lartë krahasuar me gjithë popullsinë.

Ndikimet e epidemisë Covid-19 në shëndetin dhe mirëqenjen ishin dukshëm më të larta në mesin e personave të ardhur në Finlandë në shumicën e fushave të shëndetit dhe të mirëqenjes krahasuar me gjithë popullsinë. Në hulumtimet që pasojnë do të duhej të qartësohej lidhja mes faktorëve bazë dhe asaj, se a grumbullohen ndikimet negative të epidemisë Covid-19 në disa grupe të caktuara. Poashtu, ndikimet e vërejtura pozitive aty ku ato u shqyrtuan, është e arsyeshme që të shqyrtohen edhe nga këndvështrimi i përballimit të krizës.

Fjalët kyçe: Covid-19; koronavirusi; MigCOVID; të ardhur në vend; emigrim; shëndeti; shëndeti mendor; mirëqenja; diskriminimi; aftësia e veprimit; brengat; jeta e përditëshme; mënyra e jetës.